



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 8/2 Prot

Tiranë më, 13/01/2020

Lënda: Kërkesë për shpjegime lidhur me mënyrën e detajimit të fondit të dhënë nga MASR për vitin 2020

Drejtuar: Z. Arben Ilollari
Zyra e Financës ASA

KËTU

I nderuar Z. Ilollari,

Në datë 10.01.2020 është dërguar në rrugë elektronike kërkesa e Z. Verli nr. 8 prot., datë 10.01.2020, drejtuar Bordit të Administrimit për detajimin e buxhetit të vitit 2020 për Akademinë e Studimeve Albanologjike, informacioni mbi mënyrën e detajimit të fondit të dhënë për ASA për vitin 2020 nga MASR, nr. 08/1 prot., datë 10.01.2020 i Zyrës së Financës ASA së bashku me email e MASR nëpërmjet të cilit janë dërguar fondet e miratuara në formë "Granti të mësimdhënies për vitin 2020", në total dhe i ndarë në muaj.

Në këtë komunikim është kërkuar nga ana e MASR që të dërgohet në formë zyrtare dhe elektronike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, vendimi i Bordit të Administrimit, së bashku me anekset, si dhe relacioni shoqëruar për shpërndarjen e fondeve sipas njërive për vitin 2020. Ku informacion duhet të përcillet edhe pranë MASR.

Duke vlerësuar informacionin e përgatitur nga Zyra e Financës nr. 08/1 prot., datë 10.01.2020, mbi mënyrën e detajimit të fondit të dhënë për ASA për vitin 2020 nga MASR, del e nevojshme sqarimi për disa çështje:

1. Për fondin 600 për vitin 2019 dhe vitin 2020 rezulton të jetë i njëjti nr. punonjësish dhe i njëjti numër punëtorë sezonalë, madje për vitin 2020 nuk është parashikuar udhëheqje diplomash. Por për vitin 2020, për Art 600 figuron një rritje shume nga 146.514.000 lekë në 151.600.000 lekë (konkretisht në vlerën 5.086.000 lekë).
2. Ndërkohë Art 601, për sigurime shoqërore dhe shëndetësore rezulton në ulje nga 24.500.000 lekë në 24.300.000 lekë, (diferenca prej 200.000lekë).

Për sa më sipër duhet të paraqitet informacion i detajuar lidhur me rritjen në fondin e pagave si dhe zvogëlimin në fondin për sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Në parimin logjik financiar rritja e fondit të pagave shoqërohet dhe me rritje të fondit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Ndërsa në këtë rast art 601 ka pësuar ulje.

Lutem shpjegimet përkatëse.

3. Të paraqitet pranë Bordit:
 - a. vërtetimi on line për detyrimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe për energjinë elektrike;
 - b. kontrata te mbartura nga vitet e mëparshme (detyrimet) të pa likujduara;
 - c. informacion për detyrimet për shpenzime gjyqësore;
 - d. informacion për detyrime në paga te papaguara.
 - e. Lista për të gjithë punonjësit e brendshëm të ASA, (paga dhe sigurime për 1 muaj)
4. Të paraqitet pranë Bordit informacioni mbi të dhënat financiare për të ardhurat nga aktivitetet dytësore, (tarifat e studentëve të papaguara për doktoratën apo programin e ciklit të dytë të studimit; të ardhurat e mbledhura nga qiraja e IAL Luarasi; nëse ka të ardhurat të tjera).
5. Në kuadër të kërkesës së MASR, të përgatitet relacioni shoqërues për shpërndarjen e fondeve sipas njësive të ASA për vitin 2020, si dhe shpërndarjen e te ardhurave sipas 600,601,602.
6. Të paraqitet një informacion i detajuar mbi 420 punonjësit sezonalë të angazhuar në projektet e Institutit të Arkeologjisë, të shoqëruar më një listë emërore të tyre, për angazhimin e bërë në vitin 2019 pranë ASA. Të paraqitet pranë Bordit kopje e kontratës së tyre të punës, si dhe vërtetim mbi shpërndarjen e fondit prej 12.600.000lekë të miratuar nga bordi për vitin 2019 për pagesën e punonjësve sezonalë.

Të shpjegohet nevoja për 420 punonjës të tjerë për vitin 2020 të shoqëruar me shpjegimin se në cilat procese punë/projekte do të angazhohen këta punonjës sezonalë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Heliona MIÇO
Heliona MIÇO

